



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

# PIKAT E AMANDAMENTUARA TË KODIT TË BALANCIT

Shkurt 2015



## Amandamentet e aprovuara të Kodit të Rrjetit – Kodi i Balancit

### Aktualisht:

4.4.2.1 **Rregullimi primar** duhet të fillojë menjëherë pas një devijimi të frekuencës në një situatë pothuajse të qëndrueshme prej më tepër se +/- 200 mHz, dhe të marrë efekt të plotë jo më tepër se 30 sekonda më vonë.

### Është ndryshuar në:

4.4.2.1 Aktivizimi i **Rregullimit primar** akordohet që të filloj para se devijimi i frekuencës të tejkalojë  $\pm 20$  mHz ndaj frekuencës nominale. Në rast të situatës së qëndrueshme, atëherë kur rezulton devijim i frekuencës prej  $\pm 200$  mHz nga frekuenca nominale, në këto raste e tërë rezerva e rregullimit primar duhet plotësisht të aktivizohet jo më vonë se 30 sec.

### Aktualisht:

4.5.1.2 Për qëllime të rregullimit sekondar saktësia e matjeve lokale të rregullimit të frekuencës duhet të jetë ndërmjet +/- 1 deri në 1.5 mHz.

### Është ndryshuar në:

4.5.1.2 Për qëllime të rregullimit sekondar saktësia e matjeve lokale të rregullimit të frekuencës duhet të jetë ndërmjet +/- (1.0 mHz dhe 1.5 mHz).

Përveç këtyre janë bërë edhe disa ndryshime te vogla siç janë: ndërputja e pikave 2.6.1.6 dhe 2.6.1.7, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.